



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 03.11.2025

Numër Protokolli: 7121/2025

A.nr.1585/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani -anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurën sipas ankesës A.nr.1585/2025, të datës 12.08.2025, të parashtruar nga ankuesja V.G, nga Kaçaniku, kundër Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1585/2025 të datës 12.08.2025, të parashtruar nga ankuesja V.G.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil V.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 11.08.2025, përmes emailit ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datë 12.08.2025 nën shenjë A.nr.1585/2025, kundër procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference RN00017332, për pozitën; “*Inspektor për siguri dhe shëndet në punë*”-Rajoni i Ferizajit, i shpallur nga Inspektorati i Punës, (*tani e tutje referuar IP*).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.08.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Inspektorati i Punës, ndërsa deri në momentin e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë nga organi i punësimit nuk është kthyer përgjigje në ankesë.

Kryetari i Këshillit, me datë 22.09.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 6297/2025, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjë A.nr.1585/2025 të datës 12.08.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5384/2025, të datës 12.08.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; konkursin e datës 21.03.2025 me numër Reference RN00017332 për pozitën e punës “*Inspektor për siguri dhe shëndet në punë*”-Rajoni i Ferizajit, njoftimin e datës 11.07.2025 për rezultatet përfundimtare për pozitën e punës “*Inspektor për siguri dhe shëndet në punë*”, Dokumentin e identifikimit të ankueses; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 6297/2025; vendimin A.nr.1372/2025 të datës 27.10.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës(përkundër që provat që ndërlidhen me këtë ankesë nuk janë dorëzuar nga organi i punësimit, por nga provat që janë dorëzuar nga pala ankuese si dhe janë marrë parasysht edhe provat që janë dërguar nga organin i punësimit në lidhje me ankesën A.nr.1372/2025 të datës 15.07.2025), ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që të ***përfundoi procedimi administrativ*** i filluar me ankesën e ankueses, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017332, për pozitën “*Inspektor për siguri dhe shëndet në punë*”-Rajoni i Ferizajit.

Tutje sipas provave të lëndës, rezulton se ankuesja ka aplikuar në këtë konkurs, dhe sipas njoftimit për fazën e verifikimit paraprak e njëjta rezulton se ka kaluar fazën e verifikimit paraprak për të marr pjesë në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa pas përfundimit të procesit, rezulton se ankuesja ka arrit ne testin me shkrim 57.6 pike, në vlerësimin e intervistës me shkrim ka arritur 15.4 pike, ku rezulton se gjithsejtë ka arritur 73 pike, ndërsa Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017332, më datë 11.07.2025 e ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare, ndërsa rezulton se kandidatët fitues sipas këtij procesi janë B.S-91 pikë,P.J-90.8 pikë,A.R-89.4 pikë,Xh.L-85.4 pikë,Xh.M-80.2 pikë dhe Xh.T-Z-77.8 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër kësaj procedure, pretendon se ka dyshim mbi transparencën dhe drejtësinë procesit të përzgjedhjes.

Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë ankesat që kanë qenë në shqyrtim në këshill dhe që kanë objekt të njëjtë të ankesës, ka konstatuar se për të njëjtin konkurs lidhur me kontestimin e procedurave të rekrutimit, me datë 15.07.2025 Këshilli ka pranuar ankesë nga ankuesi L.J, ndërsa me datë 27.10.2025 Këshilli ka nxjerrë Vendimin A.nr.1372/2025 përmes së cilit është aprovuar ankesa e ankuesit L.J, ndërsa është ***anuluar*** në tersi konkursi me Nr.Reference: RN00017332, për pozitën “*Inspektor për siguri dhe shëndet në punë*”-Rajoni i Ferizajit, procedurë të rekrutimit të cilën e konteston edhe ankuesja në këtë çështje administrative.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ lidhur me ankesën e ankueses A.nr.1585/2025 të datës 12.08.2025 pasi që objekti i shqyrtimit të kësaj lënde është bërë i pamundur apo i kotë, ngase përmes Vendimit A.nr.1372/2025 të datës 27.10.2025, Këshilli ka vendosur lidhur me këtë procedurë të rekrutimit sipas konkursit më shifër reference: RN00017332, për pozitën *“Inspektor për siguri dhe shëndet në punë”-Rajoni i Ferizajit*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1585/2025, datë 03/11/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses V.G;
- Inspektoratit të Punës (*Njësisë së Burimeve Njerëzore*), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.